



PLANI LOKAL I VEPRIMIT LEZHË 2024-2027 NË ZBATIM TË STRATEGJISË SË EDUKIMIT LIGJOR PËR PUBLIKUN 2019-2023

Social Inclusion for Development

2023



PLANI LOKAL I VEPRIMIT LEZHË 2024– 2027 NË ZBATIM TË STRATEGJISË SË EDUKIMIT LIGJOR PËR PUBLIKUN 2019–2023

Ky Plan Veprimi u realizua nga Hekuran Koka, ekspert i qeverisjes vendore, dhe Afërdita Gjoni eksperte e çështjeve të edukimit dhe bashkëpunimit për shoqatën SIFD- Social Inclusion for Development në kuadër të projektit “Edukimi ligjor I qytetarëve të Lezhës në kuadër të reformës administrative-territoriale 2014.” Që zbatohet me mbështetjen e projektit rajonal “SMART Balkans – Shoqëria Civile për Vlera të Përbashkëta në Ballkanin Perëndimor” i zbatuar nga Centar za promociju civilnog društva (CPCD) në partneritetet me Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) dhe Center for Research and Policy Making (CRPM) dhe i mbështetur financiarisht nga Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë (NMFA).

Përmbajtja e këtij materiali është përgjegjësi e vetme e SIFD dhe e autorit dhe jo domosdoshmërisht paraqet pikëpamjet e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Norvegjisë (NMFA), Centar za promociju civilnog društva (CPCD), Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) apo Center for Research and Policy Making (CRPM).

TABELA E PËRMBAJTJES

HYRJE	4
ÇFARË ËSHTË EDUKIMI LIGJOR I PUBLIKUT (ELP)	5
NDIHMA LIGJORE FALAS NË LEZHË.....	7
QEVERISJA VENDORE.....	8
SHOQËRIA CIVILE NË LEZHË	9
PLANI LOKAL I VEPRIMIT PËR EDUKIMIN LIGJOR LEZHË	11

Organizata "Social Inclusion for Development" (SIFD) është një organizatë e themeluar në vitin 2015, por aktivitetet e saj janë nisur zyrtarisht që nga viti 2019. SIFD u krijua fillimisht nga një grup miqsh me një pasion të fortë për të kontribuar në zhvillimin dhe përmirësimin e komunitetit të qytetit të Lezhës. Përkatësia e tyre ndaj sektoreve të ndryshëm publikë dhe privatë i ka dhënë atyre një perspektivë të thellë për të identifikuar nevojat e komunitetit dhe për të vënë re dukuritë e reja devijuese sociale. Ky grup i nismëtarëve të hershëm kishte përvojë të pasur në fushat e punës shoqërore, sociologjisë, psikologjisë, politikës dhe të drejtës. Kjo përvojë i dha mundësinë për të krijuar një staf të parë të organizatës, të përbërë nga profesionistë të fushave të ndryshme, duke përfshirë sociologë, psikologë, politologë, juristë dhe punonjës social. Ky staf i pasur me njohuri është potenciali kryesor i organizatës dhe ata janë krijuesit e vizionit dhe misionit të SIFD.

Në vlerat themelore të SIFD përfshihet vullnetarizmi, dhe organizata ka arritur të përfshijë tre vullnetarë të pasionuar në projektet e saj për të ndihmuar në rritjen dhe zhvillimin e organizatës. Angazhimi i tyre është i lirë dhe ata janë të vendosur të ndihmojnë në nxitjen e frymës së vullnetarizmit në komunitetin e tyre. Përmes hartimit, shkrimit dhe zbatimit të projekteve, ata synojnë të inkurajojnë qytetarët e të gjitha moshave të angazhohen në jetën publike të qytetit dhe të marrin pjesë në procesin e vendimmarrjes publike.

Vlerat themelore të SIFD përfshijnë vullnetarizmin, integritetin dhe partneritetin. Organizata ka një vizion të qartë për të promovuar komunitetin aktiv që jeton me dinjitet. Vizioni i saj është: "Komuniteti aktiv për të jetuar me dinjitet. SIFD, një organizatë shembullore në ofrimin e shërbimeve në Qarkun e Lezhës." SIFD është përqendruar në punën në fushat e fuqizimit social-ekonomik dhe kulturor, ndërgjegjësimin dhe advokimin, shërbimet integruara psiko-sociale dhe ligjore, metodologjinë e mësimin përmes shërbimeve, aktivitete edukuese dhe informative, këshillimin në karrierë dhe shumë sfidat tjera që lidhen me përmirësimin e komunitetit dhe të jetës së qytetarëve të Lezhës. SIFD ka bërë angazhime të mëdha për të përmbushur misionin dhe vizionin e saj, duke sjellë ndryshime pozitive në komunitetin lokal.

HJRJE

Strategjia për edukimin ligjor të publikut (SELP) përcakton vizionin, objektivat strategjikë dhe specifikë të edukimit ligjor të publikut (ELP).

Njohuritë mbi ligjin dhe edukimi ligjor i qytetarëve luajnë një rol thelbësor në çdo shoqëri demokratike, ku sjellja, veprimet dhe marrëdhëniet mes tyre dispijohen nga norma e rregulla ligjore. Këto norma e rregulla janë ndonjëherë komplekse apo u nënshtrohen ndryshimeve të vazhdueshme. Mungesa e njohurive ose njohuritë e pamjaftueshme mbi ligjin dhe legjislacionin, në përgjithësi, passjell situatën ku qytetarët nuk kuptojnë të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin prej tyre. Për më tepër, e gjitha kjo rrënjës një kulturë të mosrespektimit dhe moszbatimit të ligjit në shoqëri, e cila përbën një kërcënim të qenësishëm për shtetin e së drejtës. Kështu, informimi dhe dhënia e njohurive për ligjin, mbi të drejtat, institucionet ligjzbatuese, përgjegjësitë etj. nuk janë të lidhura vetëm me arsimimin juridik, por janë përbërësit e kulturës dhe nevojës qytetare për qasjen ndaj shtetit të së drejtës¹.

Gjithashtu, ELP ndikon drejtpërdrejt në marrëdhëniet e qytetarëve me organet e administratës publike. Duke pasur dijeni mbi legjislacionin, qytetarët kuptojnë rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve të administratës publike. Kështu, ata janë në gjendje t'ia referojnë çështjen e tyre organit përkatës, duke formuluar saktë kërkesat dhe ankesat që adreson.

Përpos raportit të qytetarëve me institucionet e administratës publike, niveli i njohurive juridike luan rol kyç në sjelljen e vetë qytetarëve në sektorë të ndryshëm të jetës, si në marrëdhëniet e tyre familjare, të punës, ato juridiko-civile, ashtu dhe në veprimet e vendimet e tyre në mbrojtje të shëndetit, sigurisë, mjedisit etj. Njohja e legjislacionit që rregullon marrëdhëniet ku qytetarët janë të përfshirë, i nxit ata të respektojnë ligjin, i bën të shmangin veprimet e jashtëligjshme dhe të reduktojnë konfliktet.

Nëpërmjet përfundimit të njohurive ligjore, si dhe rritjes së sigurisë që qytetarët ndjejnë në përdorimin e ligjit, ELP kontribuon edhe në forcimin e qytetarisë aktive dhe në një kohezion më të madh shoqëror². Qytetarët mund të organizohen e bashkëveprojnë për të mbikëqyrur veprimtarinë e organeve të pushtetit shtetëror dhe administratës publike, të ushtrojnë presion me mjete demokratike mbi këto organe, për të nxitur mbarëvajtjen e çështjeve me interes publik.

Në Analizën e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri evidentohen problematikat e lidhura me ELP, duke vlerësuar se “Institucionet shtetërore nuk kanë projekte e plane për të promovuar e mundësuar këtë formë edukimi. Nuk ka një koordinim dhe planifikim të mirë të edukimit vazhdues ligjor të publikut. Nuk ka një ndarje të detyrave institucionale dhe të shoqërisë civile, për edukimin dhe informimin vazhdues ligjor të publikut”³.

¹ “Analiza e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri”, miratuar me vendimin e Komisionit të Posaçëm Parlamentar, nr.14, dt.30.07.2015.

² Po aty.

³ “Strategjia dhe Plani i Veprimit për Reformën e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri”. miratuar me vendimin e Komisionit të Posaçëm Parlamentar, nr.15, datë 30.07.2015.

Hartimi i planit lokal të veprimit për edukimin ligjor në Lezhë është mbështetur në Strategjinë Kombëtare të Edukimit Ligjor të Publikut, dhe ka përcaktuar si objektivi kryesor për ELP rritjen e ndërgjegjësimit qytetar për rëndësinë e zbatimit të ligjit. Për realizimin e këtij objektivi parashikohet të merren disa masa konkrete, të cilat janë mbajtur në konsideratë dhe janë shtjelluar në këtë strategji.

Gjithashtu, vënia në jetë e SELP përkon me fillimin e zbatimit të ndryshimeve kushtetuese dhe ligjore, të miratuara në kuadër të reformës në drejtësi si dhe në vazhden e ndryshimeve të mëdha që rezultojnë nga Reforma Administrative dhe Territoriale (RAT) e vitit 2015. Pavarësisht se shumë funksione iu deleguan me ligjin 139/2015 qeverisjes vendore, ka ende boshllëqe ligjore dhe moskuptueshmëri të ligjit për shumë nga këto funksione që janë shkëputur nga qeverisja qendrore por ende nuk po përqafohen si duhet nga qeverisja vendore (si psh. Shëndeti parësor apo arsimi parashkollor)⁴.

SELP bazohet në vlerësimin mbi gjendjen aktuale të ELP në Shqipëri dhe hartimi i saj është udhëhequr nga këto parime:

- a) respektim i ligjshmërisë në të gjitha fushat e jetës;
- b) qeverisje e hapur, që garanton transparencë dhe llogaridhënie në vendimmarrje, politikbërje dhe ligjbërje;
- c) koordinim dhe bashkëveprim institucional në funksion të edukimit ligjor të publikut;
- d) akses i barabartë i individëve në edukimin ligjor;
- e) profesionalizmi në ofrimin e edukimit ligjor;
- f) edukim ligjor i vazhdueshëm i shoqërisë, duke ofruar njohuri dhe dije në përputhje me nevojat e gjithësecilit dhe komuniteteve në nevojë.

ÇFARË ËSHTË EDUKIMI LIGJOR I PUBLIKUT (ELP)

Një nënë nga komuniteti Rom në qytetin e Lezhës kishte disa fëmijë të parregjistruar dhe, edhe pse në kushte të varfërisë ekstreme, nuk arrinte të merrte as ndihmën ekonomike të përcaktuar nga qeveria. Kur u pyet se pse nuk i kishte regjistruar fëmijët, ajo u përgjigj se kishte shkuar njëherë te gjendja civile dhe atje i ish in përgjigjur se duhej të sillte disa dokumenta të tjera, të cilat ajo nuk e kishte idenë se ku duhej të merreshin, dhe për këtë arsye kishte vazhduar jetën me fëmijët të parregjistruar. Dhe taqshmë kishte 4 fëmijë ku i madhi ishte 10 vjeç, por që për shtetin nuk egzistonin asnjëri. Me ndihmën e organizatave për mbrojtjen e të drejtave të Romëve, kjo nënë arriti të rregjistronte fëmijët e saj, dhe ti dërgonte në shkollë e në kopësht, të futej në skemën e ndihmës ekonomike dhe të përfitonte nga skemat e tjera të ndihmës.

Ky është një shembull bazë i kuptimit të edukimit ligjor, dhe ndihmës ligjore falas që duhet t'u ofrohet, sidomos atyre shtresave më në nevojë. Divorcet, ditët e kaluara në paraburgim përtej afateve ligjore, birësimi i fëmijëve, kanë qenë çështje që janë adresuar ndërkohë nga OJq që merren me ndihmë ligjore falas në Lezhë. Edukimi ligjor i qytetarëve është ndërgjegjësimit dhe

⁴ <https://www.idrainstitute.org/files/star2/Local%20Governance%20Mapping%20in%20Albania.pdf>

kuptimi i drejtë i të drejtave dhe lirive të njeriut dhe mundësive ligjore për t'i gëzuar këto të drejta.

Grupet e synuara të veprimtarisë së edukimit ligjor janë ato të cilat kanë shfaqur nevojë më të madhe për t'u njohur me garancitë kushtetuese dhe ligjore siç janë nxënësit e shkollave të mesme dhe universiteteve, aktivistët e shoqërisë civile, personat e privuar nga liria dhe shtresat e tjera në nevojë, votuesit për herë të parë, etj.

Njohja me kuadrin ligjor dhe edukimi ligjor i qytetarëve luajnë një rol thelbësor në çdo shoqëri demokratike ku sjellja, veprimet dhe marrëdhëniet mes tyre dispijohen nga norma apo rregulla ligjore. Ligjet, normat dhe rregullat janë shpesh komplekse, shkruar me një gjuhë jo shumë të kuptueshme për shtresat vulnerabël, dhe që pësojnë ndryshime të vazhdueshme. Njohuritë e pamjaftueshme mbi ligjin dhe legjislacionin në përgjithësi shpie në situatë, si rasti më sipër, ku qytetarët nuk kuptojnë të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin prej tyre. Mosedukimi ligjor I publikut prej shumë vitesh ka sjellë një kulturë të mosrespektimit dhe moszbatimit të ligjit në shoqëri, gjë e cila përbën kërcënim të qenësishëm për shtetin e së drejtës.

Aksesi i publikut në njohuritë mbi ligjin është themelor për garantimin e një sistemi drejtësie efektiv. Kështu, informimi dhe dhënia e njohurive për ligjin, mbi të drejtat, institucionet ligjzbatuese, përgjegjësitë, etj., nuk janë të lidhura vetëm me arsimimin juridik, por janë përbërësit e kulturës dhe nevojës qytetare për qasjen ndaj shtetit të së drejtës⁵.

Gjithashtu, edukimi ligjor i publikut ndikon drejtpërdrejt në marrëdhëniet e qytetarëve me nëpunësit dhe organet publike të qeverisjes. Duke patur dijeni mbi legjislacionin, qytetarët kuptojnë rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve të administratës publike. Kështu, ata janë në gjendje t'ia referojë çështjen e tyre organit përkatës, duke formuluar saktë kërkesat dhe ankesat që adreson.

Përpos raportit të qytetarëve me institucionet e administratës publike, niveli i njohurive juridike luan rol kyç në sjelljen e vetë qytetarëve në sektorë të ndryshëm të jetës, qoftë në marrëdhëniet e tyre familjare, të punës, atyre juridiko-civile, qoftë në veprimet dhe vendimet e tyre në mbrojtje të shëndetit, sigurisë, mjedisit, etj. Njohja e legjislacionit që rregullon marrëdhëniet ku qytetarët janë të përfshirë, i nxit ata të respektojnë ligjin, i bën të shmangin veprimet e jashtëligjshme dhe të reduktojnë konfliktet.

Nëpërmjet përfundimit të njohurive ligjore, si edhe rritjes së sigurisë që qytetarët ndjejnë në përdorimin e ligjit, edukimi ligjor kontribuon edhe në forcimin e qytetarisë aktive dhe në një kohezion më të madh shoqëror. Qytetarët mund të organizohen dhe të bashkëveprojnë për të mbikëqyrur veprimtarinë e organeve të pushtetit shtetëror dhe administratës publike, të ushtrojnë presion me mjete demokratike mbi këto organe, për të nxitur mbarëvajtjen e çështjeve me interes publik⁶.

Edukimi ligjor i publikut ka për qëllim t'u sigurojë individëve njohuritë e nevojshme lidhur me të drejtat e tyre dhe kuadrin ligjor në fuqi, si edhe për t'i aftësuar ata në zgjidhjen e

⁵ Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Analiza e Sistemit të Drejtësisë, fq. 215
http://www.reformanedrejttesi.al/sites/default/files/dokumenti_shqip_0.pdf

⁶ Po aty

mosmarrëveshjeve, duke u siguruar kështu akses në drejtësi. Edukimi ligjor i ndihmon qytetarët të kuptojnë kur mund të kenë nevojë për mbështetje ligjore, çfarë lloj ndihme apo këshille mund të kërkojnë, ku dhe si ta kërkojnë atë. Thënë kjo, është e nevojshme të bëhet dallimi mes edukimit ligjor të publikut dhe arsimit ligjor, I cili u drejtohet profesionistëve të drejtësisë, atyre të cilët do të merren më hollësisht me përdorimin e ligjit, si studentët e drejtësisë, magistratët, avokatët, përmbaruesit etj...

NDIHMJA LIGJORE FALAS NË LEZHË

Si një pjesë e rëndësishme dhe e pandarë e edukimit ligjor të publikut është edhe Ndihma Ligjore Falas dhe rrjeti I saj të cilët informojnë publikun dhe kryesisht shtresat e marginalizuara mbi mundësitë e përfitimit të ndihmës ligjore falas, dhe i orientojnë dhe ndihmojnë për përfitimin e kësaj ndihme.

Bazuar në ligjin Nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike falas”, të gjithë qytetarët që përfshihen në kategoritë e përcaktuara nga ligji mund të përfitojnë ndihmën juridike falas, sipas përcaktimeve në këtë ligj. Ndihma juridike ofrohet pranë Qendrave të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore të organizuara kryesisht në rang qarku, me zyrat që janë të vendosura pranë disa institucioneve publike, si gjykata, bashkia, këshilli I qarkut, etj. I gjithë ky process koordinohet nga DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS⁷ pranë Minsitrisë së Drejtësisë.

Gjithashtu edhe pranë disa institucioneve të arsimit të lartë funksionojnë Klinikat Ligjore, të cilat ndihmojnë qytetarët për qasjen në system. Ndihma ligjore falas mund të merret edhe online në platformën juristonline.al⁸, e cila është e përshtuar edhe në aplikacion për telefon Android ose Ios. Informacioni gjendet edhe në numrin pa pagesë 08001010⁹.

Në Lezhë QSH ndodhet pranë Z1N të bashkisë Lezhë, në shëshin “Gjergj Kastrioti”. Pranë kësaj zyre mund të plotësohet dokumentacioni i nevojshëm për t’u paraqitur në Gjykatë e cila vlerëson nëse çështja ka nevojë për përfaqësim juridik tej mundësive ekonomike të personave të interesuar, dhe më pas i kalohet Dhomës së Avokatisë e cila përcakton avokatin i cili do të marrë përsipër çështjen.

Disa organizata joqeveritare gjithashtu janë bërë pjesë e rrjetit dhe shpesh ofrojnë ndihmën ligjore, duke qenë se këto organizata kanë të drejtën e përfaqësimit të palës së interesuar me avokatët e tyre. Këto organizata kanë aktivitetin e tyre edhe në Lezhë, dhe pranë Qendrave të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore mund të gjenden adresat e këtyre organizatave.

Qeverisja vendore si dhe OSHC-të e ndryshme bashkëpunojnë me QSHNJP për të referuar raste të ndryshme, të cilat I hasin gjatë punës së përditshme në terren.

⁷ <https://ndihmajuridike.gov.al/>

⁸ <https://juristonline.al/>

⁹ <https://ëëë.drejtësia.gov.al/ëp-content/uploads/2020/08/Manual-Ndihma-Juridike-NEË.pdf>

QEVERISJA VENDORE

Demokracia vendore përmes qeverisjes vendore me pjesëmarrje/ transparencë dhe përgjegjshmëri, është ende e brishtë në bashkitë tona dhe pse janë bërë ndërhyrje me parashikime ligjore të qarta me të drejtën e ankesës, kërkesës dhe iniciativës qytetarë në Ligjin organik, me mekanizma të ushtrimit të të drejtës për informim (kordinatori dhe regjistri i kërkesave, faqja zyrtare e bashkisë etj). Këto mekanizma janë në realitet mjaft ambiciozë për tu zbatuar në të gjitha bashkitë nisur nga mundësitë reale të administratës dhe infrastrukturës lokale për mundësimin e tyre. Bashkia Lezhë, si administrate ashtu edhe Këshilli, janë angazhuar dhe në eksperiencë më të thjeshta dhe më të drejtpërdrejta për të stabilizuar kanale komunikimi kryesisht me takime të kryetarit apo konsultime tashmë të konsoliduara për paketën fiskale dhe planifikimin buxhetor.

Vetëqeverisja vendore është e drejta e qytetarëve për të rregulluar disa funksione në mënyrë të drejtpërdrejtë ose nga njerëz dhe organe institucionale që zgjidhen drejtpërdrejt nga qytetarët. “Autonomi vendore” është e drejta dhe aftësia e njësive të vetëqeverisjes vendore, të krijuara sipas Kushtetutës dhe këtij ligji dhe në kuadër të kufizimeve të tij, që të rregullojnë dhe të administrojnë një pjesë thelbësore të çështjeve publike nën përgjegjësinë e tyre dhe në interes të bashkësisë.¹⁰ Në Shqipëri kjo realizohet në bazë të parimit të decentralizimit dhe të autonomisë vendore¹¹.

Aspektin e vet më të dukshëm, autonomia e qeverisja vendore e shpreh në përcaktimin e qartë të kompetencave të njësive të qeverisjes vendore, të parashikuara në Kushtetutë (nenet 108 deri 115) dhe në bazë të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe të ligjeve të tjera sektoriale, për të vendosur vetë për problemet që hyjnë në juridiksionin e tyre. Përcaktimi i kompetencave nga Kushtetuta garanton qëndrueshmërinë e kompetencave të qeverisjes vendore, ndaj statusi kushtetues i qeverisjes vendore ka si rezultat edhe autonominë e saj.

Edhe në kuadër të planit lokal të veprimi për edukimin ligjor të publikut duhen mbajtur parasysh tre parimet kryesore të qeverisjes, si shteti unitar, ndarja e niveleve të qeverisjes, marrdhënia juridike mes organeve të qeverisjes vendore me ato qendrore, ku këto marrdhënie takohen apo ndahen, dhe sa ndikojnë në mirëpërcaktimin e kompetencave dhe ndarjen e detyrave në mënyrë sa më efektive që të mos krijojnë konfuzion të qytetarët, por nganjëherë edhe të vetë nëpunësit.

Në një shtet demokratik, parimi i ndarjes dhe balancimit të pushteteve, si dhe parimi i decentralizimit dhe autonomisë lokale, nuk kërkon vetëm mosndërhyrjen në kompetencat e organeve që i përkasin niveleve të ndryshme të qeverisjes, por gjithashtu kërkon dhe bashkëpunimin reciprok mes tyre, përderisa qëllimi i përveçëm i çdo organi në cilindo nivel është forcimi i demokracisë në interes të vendit dhe dhënia e shërbimeve sa më efektive për qytetarët.

Mardhëdhëniet mes nivelit qendror dhe vendor janë një faktor kyç në zhvillimin vendor dhe kombëtar, sepse sigurojnë një sinergji të përpjekjeve dhe sjellin decentralizim të suksesshëm.

¹⁰ Ligji 139/2015, neni 2.2

¹¹ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 13

SHOQËRIA CIVILE NË LEZHË

Së pari, shoqëria civile është një komunitet i caktuar, dmth banorët e një fshati, lagjeje, apo një bashkim tjetër i banorëve që kanë interesa të përbashkëta dhe që organizohen për të ruajtur këto interesa është shoqëria bazë civile. Kjo shoqëri organizohet në mënyrë vullnetare apo në format e përcaktuara me ligj, ku një nga format kryesore të shprehjes së vullnetit janë zgjedhjet për qeverisjen vendore dhe këshilltarëve që do t'i përfaqësojnë në vendimarrje. Gjithashtu komuniteti mund të shprehë vullnet edhe nëpërmjet peticioneve, nismave qytetare, referendumeve, përfaqësim të drejtpërdrejtë, etj.

Sipas UNESCO shoqëria civile janë organizatat e vetëngritura, autonome, që organizohen përtej kuadrit shtetëror dhe jo për qëllime tregtie. Për më tepër, shoqëria civile është një trupë civile e cila, duke vepruar në marginën e shteteve, në një farë kuptimi si një fuqi kundërbalancuese dhe kryesisht nëpërmjet demokracisë pjesëmarrëse, ndikon në vendimet politike dhe ekonomike. Së fundi, në kontekstin e globalizimit dhe qeverisjes globale, koncepti i shoqërisë civile përdoret edhe në fushën e solidaritetit ndërkombëtar¹².

Sipas përcaktimeve ligjore të BE shoqëria civile i referohet të gjitha formave të veprimit shoqëror që kryhen nga individë ose grupe që nuk janë as të lidhur dhe as të menaxhuar nga autoritetet shtetërore. Organizata e shoqërisë civile është një strukturë organizative anëtarët e së cilës i shërbejnë interesit të përgjithshëm përmes një procesi demokratik dhe e cila luan rolin e ndërmjetësit midis autoriteteve publike dhe qytetarëve.

Neni 15 i Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian njihë rolin e shoqërisë civile në qeverisjen e mirë të Bashkimit Evropian (BE). Neni 11 i Traktatit për Bashkimin Evropian thekson nevojën që BE-ja të ketë një dialog të hapur, transparent dhe të rregullt me organizatat e shoqërisë civile, për shembull kur përgatit propozime për ligjet e BE-së.

Shembuj të organizatave të tilla përfshijnë:

- partnerët socialë (sindikatat dhe grupet e punëdhënësve);
- organizatat joqeveritare (p.sh. për mbrojtjen e mjedisit dhe të konsumatorëve);
- organizatat bazë (p.sh. grupimet e të rinjve dhe familjeve).

Komiteti Ekonomik dhe Social Evropian përfaqëson organizatat e punëtorëve dhe punëdhënësve në nivel të BE-së dhe ka një rol jetik në procesin ligjvënës të BE-së. Komitetet sektoriale të dialogut social janë krijuar për të përfshirë më tej partnerët socialë në procesin e vendimmarrjes¹³.

Prandaj mund të themi, se shoqëria civile është fusha e organizuar e jetës sociale, që është vullnetare, gjërisht e vetmjaftueshme dhe autonome prej Shtetit. Së fundmi, duke qenë se për të ndërvepruar duhet të veprohet me organizma të njohur, organizatat e shoqërisë civile në këtë

¹² UNESCO and civil society, fq. 12, 2008, Unesco

¹³ <https://eur-lex.europa.eu/EN/legal-content/glossary/civil-society-organisation.html#:~:text=A%20civil%20society%20organisation%20is,between%20public%20authorities%20and%20citizens.>

dokument janë organizata të rregjistruara si të tilla, bazuar në ligjin shqiptar nr.8788, datë 7.5.2001 “Për organizatat jofitimprurëse”.

Roli i shoqërisë civile në një sistem qeverisje të decentralizuar kryen kryesisht këto funksione:

- funksionin e avokatit për paraqitjen e interesave të zonave të tyre,
- funksionin dhënies së shërbimeve në nivel lokal në fushat e edukimit, shëndetit, të pastrimit, etj,
- funksionin e partnerit të qeverisë në planifikimin e zhvillimit, të mobilizimit të burimeve dhe të promovimit për një kuptim më të mirë të sistemit të decentralizimit,
- funksionin e mbikqyrjes së aktivitetit qeveritar.

Të gjithë aktorët e shoqërisë civile nuk luajnë këto funksione në çdo moment dhe funksionet e shoqërisë civile nuk janë gjithmonë shumë të qarta dhe të ngurta. Funksionet e përmendura më sipër kanë kuptimin që mbulohen nga aktorët e ndryshëm të shoqërisë civile...

Në Bashkinë Lezhë ka disa organizata që luajnë rol të caktuar në fushën e jetës publike. Sipas regjistrimit të Agjensisë për Mbështetjen e Shqoërsisë Civile (AMSHC), në Lezhë ka disa organizata active. Nga një këndvështrim që hedhim këto organizata mund të ndahen në disa role, si psh, organizata fetare dhe edukuese si Caritas Dioqezan, Ambasadorët e Paqes, Qendra Shën Jozefi Punëtor; organizatat e komuniteteve minoritare, si Integrimi I Romëve të Veriut (IRV) apo Romët e Veriut (ReV), organizatat rinore si Komiteti Rinor Lezhë, Qendra "Hand to Hand Against Nation Apathy" (H.A.N.A.), organizatat e grave si Gruaja Vizioni i Ndryshimit, si dhe organizatat me focus zhvillimin socio-ekonomik local si LERDA, SIFD – social Inclusion for Development apo Opportunity Balance and Overcoming.

Organizata të tjera me qendër në Tiranë janë active dhe veprojnë në Lezhë si Mary Ēard Loreto, Terre Des Hommes, Qendra ALTRI, Drejtësi Sociale, etj.

PLANI LOKAL I VEPRIMIT PËR EDUKIMIN LIGJOR LEZHË

Në kuadër të përforcimit të edukimit ligjor të publikut, si zbatim I Strategjisë për Edukimin Ligjor të Publikut Edukimi, SIFD po zbaton në Lezhë projektin “Edukimi ligjor I qytetarëve të Lezhës në kuadër të reformës administrative-territoriale 2014.”

Ky project ka 2 obejktiva specifik:

1. Të zhvillojmë një fushatë informuese mbi funksionet dhe kompetencat e institucioneve vendore në 10 Njësitë Administrative në varësi të Bashkisë Lezhë, duke përfshirë dhe organizatat e shoqërisë civile.
2. Të advokojmë në Bashkinë Lezhë dhe Këshillin Bashkiak për ngritjen e pozicionit të “Koordinimit të Edukimit Ligjor”, sipas Strategjisë për Edukimin Ligjor të Publikut 2019-2023.

Nga ky project pritet që të paktën 50 qytetarë të Lezhës, kryesisht të rinj dhe gra do të njohin më saktë dhe qartë institucionet e qeverisjes vendore, kompetencat që këto institucione kanë dhe shërbimet që ato duhet të ofrojnë për qytetarët e Lezhës. Gjithashtu është zhvilluar një fushatë advokuese për ngritjen e pozicionit të “Koordinatorit të Edukimit Ligjor”, pranë Bashkisë Lezhë si dhe është hartuar ky Plan Lokal Veprimi për Edukimin Ligjor për vitet 2024-2027 sipas Strategjisë për Edukimin Ligjor të Publikut 2019-2023.

Targeti kryesor I projektit janë të rinjtë dhe gratë e grupmoshës 15-45 vjeç të cilët jetojnë në 10 Njësitë Administrative të Bashkisë Lezhë. Ky target grup e ka të nevojshme që të njohë më mirë institucionet e qeverisjes vendore dhe të dijë funksionet, kompetencat dhe shërbimet që këto institucione ofrojnë për qytetarët e Lezhës.

Gjithashtu projekti ka punuar edhe me organizatat e shoqërisë civile të cilat punojnë dhe funksionojnë në territorin e Bashkisë Lezhë.

Një ndër aktivitetet kryesore të projektit “Edukimi ligjor I qytetarëve të Lezhës në kuadër të reformës administrative-territoriale 2014” në kuadër të realizimit të objektivit të dytë të këtij projekti dhe zbatimit të Strategjisë për Edukimin Ligjor të Publikut 2019-2023 është hartuar ky Plan Veprimi Lokal për Edukimin Ligjor të qytetarëve të Lezhës. Ky Plan Veprimi do të jetë për një periudhë 3 vjeçare dhe do t'i dorëzohet Bashkisë Lezhë si institucioni përgjegjës për zbatimin e saj. Në hartimin e këtij plani lokal do të përfshihen organizata lokaale të shoqërisë civile në Lezhë, duke u bërë pjesë edhe ato të një Rrjeti Lokal për Kontrollin dhe Zbatueshmërin e Planit Lokal. Ky rrjet do të ngrihet mbi bazën e një memorandum bashkëpunimi për veprimtari të përbashkëta për realizimin e këtij plani.

TABELA 1							
Nr.	Masat në zbatim të objektivave specifike	Institucionet përgjegjëse		Afati i zbatimit		Kosto indikative (në mijë lekë)	Shenime
		Institucioni përgjegjës	Institucion kontribuues (nëse ka)	Afati i fillimit	Afati i mbarimit		
1.1	Objektivi specifik 1.1: Përmirësimi i legjislacionit me qëllim parashikimin e parimeve e formave të ELP-së dhe përfshirjen e ELP-së në përgjegjësitë e institucioneve						
1.1.1	Raporti i vlerësimit të nevojave për përmirësim të kuadrit ligjor dhe institucional të ELP-së i hartuar			2025	2027	200	
1.1.1 a	Ngritja e Grupit Institucional të Punës për kryerjen e studimit mbi nevojat për përmirësim të kuadrit ligjor dhe institucional (I) Hartimi i raportit paraprak mbi nevojat (II) Konsultimi i raportit paraprak me anëtarët e Rrjetit (III) Hartimi dhe publikimi i raportit përfundimtar mbi nevojat për përmirësim të kuadrit ligjor dhe institucional të ELP (IV)	SIFD	Bashkia, degët territoriale të dekoncentruara, OSHC	dhejtor 2024	6M I 2024	Kosto administrative	
1.1.2	Vendime, urdhëra dhe urdhëresa të hartuara dhe të miratuara, në përputhje me rekomandimet e raportit përfundimtar të vlerësimit të ELP-së			2024	2027		
1.1.2 a	Numri i vendimeve, urdhërave dhe udhëzimeve të hartuara dhe të miratuara	Bashkia, Degët rajonale të institucioneve të dekoncentruara		2024	2025	Kosto administrative	
1.1.2 b	Numri i akteve rregulluese të miratuara në nivel NJQV-të: (Rregullorja për konsultimin publik/ Rregullorja për të Drejtën e Peticionit, Ankesave dhe iniciativën qytetare/Rregullorja e Këshillit Bashkiak/ *Aktet që do të/mund të ndryshohen do të parashikohen saktësisht në varësi të kërkesave të institucioneve propozuese	Këshilli Bashkiak	Shoqata e Bashkive/ OSHC	2024 (miratuar tashme)	2024 (rishikimet e nevojshme)	150	

Edukimi ligjor I qytetarëve të Lezhës në kuadër të reformës administrative-territoriale 2014

	Mbështetje për ndërgjegjësimin e bashkive në lidhje me detyrimet mbi ligjin nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile" /Përmirësimi i akteve ligjore/nënligjore për Prefektin e qarkut	Prefektura	OSHC	2025		100	
1.2	Objektivi Specifik 1.2: Rritja e vazhdueshme e burimeve financiare nga buxhetet e institucioneve lokale dhe donatorët për ofrimin e ELP-së						
1.2.1	Aktivite ndërgjegjësuere dhe advokuese për rritjen e nivelit të financimit të aktiviteteve të parashikuara në PV të SELP nga donatorët, të realizuara			2024	2024		
1.2.1 a	Krijimi i databazës së donatorëve që mbështesin aktivitete të ELP-së	Bashkia, SIFD	Drejtoritë rajonale, OSHC	2025	2024		
1.2.1 b	Zhvillimi i një konference lokale për të rritur ndërgjegjësimin e përdorimit të ELP-së	Bashkia	Drejtoritë rajonale, SIFD OSHC	2024	2024	200	
1.2.2	Përmirësimi i planifikimit buxhetor të institucioneve publike dhe përfshirja në prioritetet e programit Reload te Bashkisë Lezhë të ELP-së						
1.2.2.a	Integrimi në prioritetet e Reload (thirrje për projekte e bashkisë Lezhë) në fushën e edukimit ligjor të publikut	Bashkia Lezhë (drejtoria e Integrimin)		2024	Në vijim	Kosto administrative	
1.3	Objektivi Specifik 1.3: Sigurimi i burimeve njerëzore të nevojshme për të mundësuar ndërhyrjen me efektivet në ofrimin e ELP-së						
1.3.1	Identifikimi e vlerësimi i nevojave për burime njerëzore në nivel bashkie dhe drejtorie rajonale						
1.3.1 a	Përcaktimi i një koordinatori që ofron edukimin/orientimin ligjor të publikut, në institucionet qendrore dhe vendore	Bashkia Lezhë, Drejtoria Rajonale e Policisë, DRAP, etj	Drejtoritë rajonale	2024	2027	2400	
1.3.1 b	ELP i të papunëve, kryesisht i grupeve në nevojë mbi legjislacionin në fushën e punësimit, migracionit për motive punësimi dhe arsimit e formimit profesional	Zyra Rajoanle e Punës	Drejtoria e Shërbimit Social në BL dhe Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social	2025	2025	Kosto administrative	
2.1	Objektivi Specifik 2.1: Institucionalizimi i bashkëpunimit ndërinstucional me qëllim koordinimin dhe bashkërendimin e iniciativave të ELP-së						
2.1.1	Krijimi i strukturës (Rrjeti) ndërinstucionale përgjegjëse për edukimin ligjor të publikut dhe përcaktimi i kuadrit rregullator të veprimtarisë së tij	Bashkia, SIFD	Drejtoritë rajonale, OSHC	2025	2026	Kosto administrative	

Edukimi ligjor I qytetarëve të Lezhës në kuadër të reformës administrative-territoriale 2014

2.1.1 a	Rregullore e Rrjetit e hartuar dhe e miratuar (I); publikim/njoftim i ngritjes së Rrjetit (II); nr. i publikimeve të kryera në ueb të anëtarëve të rrjetit	Bashkia	Gjithë anëtarët e rrjetit	2025	2024	Kosto administrative	
2.1.2	Transparencë e shtuar e veprimtarisë dhe aktiviteteve të ndërmarra në kuadër të ELP-së			2025	2024	Kosto administrative	
2.1.2 a	Përditësimi i seksionit të edukimit ligjor në faqet ueb të krijuar (I) Hedhja e të dhënave mbi aktivitete që ndërmerren për ELP-në në fushën e legjislationit sipas fushës së përgjegjësisë së çdo organizate (anëtarë të Rrjetit) dhe të autoriteteve tjera publike	Bashkia	Autoritete Publike e jopublike (anëtarë të Rrjetit)	6M I 2024	Në vijim	Kosto administrative	
2.1.2 b	Aktivitete ndërgjegjësuere e advokuese ndaj institucioneve përgjegjëse për ofrimin e ELP-së me qëllim edukimin ligjor për PAK	Drejtoria e shërbimit social në Bashkia, Drejtoria Rajonale e shërbimit social shtetëror	OSHC	6M I 2025	6M II 2025	Kosto administrative	
2.1.3	Krijimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i mekanizmave të bashkëpunimit dhe komunikimit të Rrjetit me publikun dhe median			2025	2024	Kosto administrative	
2.1.3 a	Kaktimi i personit përgjegjës për komunikimin e Rrjetit me median dhe publikun (I) Komunikim\i dhe ndërveprimi midis institucioneve publike dhe qytetarëve dhe medias në kuadër të ELP-së, i përmirësuar dhe i lehtësuar (II)	Bashkia		6M II 2025	Në vijim	Kosto administrative	
2.2	Objektivi Specifik 2.2: Konkretizimi i bashkëpunimit ndërinstytucional nëpërmjet realizimit të iniciativave të përbashkëta të ELP-së						
2.2.1	Iniciativat e përbashkëta ndërinstytucionale të ELP-së të zhvilluara dhe përditësuara (të paktën 3 iniciativa/vit)			2025	2024		
2.2.1 a	Edukimi ligjor i grupeve të interesit për heqjen e qeses plastike nga përdorimi	Spektori i Mjedisit në Bashki, Drejtoria rajonale e mjedisit	OSHC	6M I 2024	6M II 2024		
2.2.1 b	Edukimi ligjor i grupeve të interesit mbi kuadrin ligjor të përditësuar për barazinë gjinore/DHBGJ dhe dhuna në familje në kuadër të fushatës “16 ditët e aktivizimit të DHBGJ” *Aktiviteti kryhet çdo vit në periudhën 25 nëntor–10 dhjetor	Komisioni i Barazisë Gjinore në KB, Drejtoria e shërbimit social në bashkia	OSHC	6M II 2025	6 M II 2024	200	

Edukimi ligjor I qytetarëve të Lezhës në kuadër të reformës administrative-territoriale 2014

2.2.1 c	Edukimi ligjor i qytetarëve dhe grupeve në nevoje mbi ligjin për ndihmën juridike falas, shërbimet sociale të ofruara nga Bashkitë dhe procedurat e ankimit (fletëpalosje, broshura, edukim ligjor në njësi administrative, forume).	Zyra e Edukimit Ligjor në Bashki	OSHC	6M II 2025	6M I 2024	150	
2.2.4	Iniciativat e përbashkëta midis OSHC-ve/klinikave të ligjit dhe organit që administron ndihmën juridike falas/ZJF të zhvilluara			2024	2027		
2.2.4 a	Fushata sensibilizimi mbi ligjin për ndihmën juridike falas (fletëpalosje/takime/aktivitete përbashkëta institucionale): korrik 2024: zhvillimi i një fushate ndërgjegjësuere me aktorët e shoqërisë civile/institucionet publike në qytetin e Shëngjinit (aktivitete në vijimësi gjatë kohës së zbatimit të këtij PV)	Zyra e ndihmës ligjore falas Lezhë	OSHC	6M I 2024	6M II 2025	300	
2.2.4 b	Realizimi i iniciativave të përbashkëta midis OSHC-ve/klinikave të ligjit dhe ZJF: 3 tryeza të rrumbullakëta me përfaqësues të ZJF - 6M II 2024:	ZJF	Shkollat e mesme të larta në Lezhë, OSHC	6M I 2024	Në vijim	Kosto administrative	
2.2.4 c	Përgatitja e materialeve promovuese për avokatët që ofrojnë ndihmë juridike të garantuar nga shteti bazuar në kërkesat dhe kategoritë e grupeve vulnerabël, të ligjit të ndihmës juridike dhe ligjit për profesionin e avokatit	DHA Lezhë	ZJF	6M II 2025	Në vijim	200	
3.1	Objektivi specifik 3.1: Rritja e aksesit të publikut në informacionin ligjor dhe pasurimi i vazhdueshëm i njohurive juridike të tyre në përputhje me nevojat specifike						
3.1.1	Hartimi i materialeve që fokusohen në tema të veçanta ligjore dhe/ose me interes për grupe të qytetarëve me nevoja të veçanta, në formate të përshtatshme lehtësisht të aksesueshme	Bashkia, ZJF	Te gjitha drejtorite, Drejtorite rajonale, OSHC	2025 2025			
3.1.1 a	Vlerësim mbi nevojat prioritare dhe imediate të qytetarëve për ELP-të(I) Identifikimi i autoriteteve kryesore rajonale dhe vendore të cilat duhet të përmbledhin informacion ligjor në gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme për publikun, sipas fushës së tyre të veprimtarisë (II) Brenda vitit 2024: zhvillimi i aktiviteteve/sesioneve të informimit në gjimnaze, duke filluar me qytetin e Shëngjinit, e duke vijuar me qytetin e Lezhës dhe njesitë e tjera administrative. (përgatitje e materialeve në një gjuhë të thjeshtë e të kuptueshme).	Prefekti, Bashkia ZJF	ZVAP OSHC	6M I 2024	6M II 2025	Kosto administrative	

Edukimi ligjor I qytetarëve të Lezhës në kuadër të reformës administrative-territoriale 2014

3.1.1 b	Aktivitete ndërgjegjësuese për edukimin ligjor të fëmijëve; Zhvillimi i aktiviteteve sensibilizuese pranë institucioneve arsimore, shëndetësore, vendore, dhe të tjera/viti 2024 *Aktivitetet do të jenë në vijimësi të kohës së zbatimit të këtij plani veprimi	Njësia për mbrojtjen e fëmijëve	Aleanca e Grave Këshilltare, Institucionet arsimore, OSHC	2024	6M II 2025	150	
3.1.1 c	Përgatitja dhe shpërndarja e materialeve për ELP për barazinë gjinore, DHBGJ dhe dhunën në familje, viktimat e veprës penale, viktimat e trafikimit, për fëmijët, për gratë dhe grupet e tjera të cenueshme, me një gjuhë të kuptueshme të përshtatshme për PAK, fëmijët dhe romët e egjiptianët (aktivitetet e parashikuara nga AP fillojnë zbatimin nga 6M II 2024)	Njësia e Mbrojtjes së Gruas	Aleanca e Grave Këshilltare, Institucionet fetare, OSHC	6 M II 2024	6M II 2025	200	
3.1.1 d	Përgatitje dhe shpërndarje e fletëpalosjeve për informimin dhe ndërgjegjësimin e fëmijëve/të miturve, për të drejtat dhe mbrojtjes së tyre për fëmijët/të miturit (aktivitetet e parashikuara nga AP fillojnë zbatimin nga 6M II 2024)	Njësia për mbrojtjen e fëmijëve	Urdhri i psikologut	6M II 2024	6M I 2025	100	
3.1.2	Publikimi i materialeve online dhe shpërndarja e tyre në formate të përshtatshme lehtësisht të aksesueshme			2024	2025		
3.1.3	Mekanizma për të përmirësuar bashkëpunimin e vazhdueshëm me median	Bashkia Unioni i Gazetarëve Lezhë		2024	2025		
3.1.3 a	Informimi i qytetarëve për iniciativat e reja ligjore dhe ndryshimet e ligjeve në mënyrë të vazhdueshme në formate të thjeshta dhe të kuptueshme për publikun (programe për çështjet e Këshillit Bashkiak; video-transmetim i drejtpërdrejtë i mbledhjes së Këshullit dhe të komisioneve) *Aktivitetet në vijimësi të kohëzbatimit të PV (përgjatë dy 6M)	Këshilli Bashkiak	Media lokale OSHC	6M I 2024	6M II 2025		
3.1.3 b	Realizimi i programacioneve mediatike/ intervistave dhe diskutimeve në TV lokale dhe blege, si dhe në radio nga anëtarët e Rrjetit me tematika të ndryshme ligjore sipas sektorëve përkatës	Unioni i gazetarëve Lezhe	Bashkia OSHC	6M I 2024	6M II 2025	200	
3.2	Objektivi specifik 3.2: Informimi dhe ndërgjegjësimi i gjerë i publikut nëpërmjet fushatave mediatike në një fushë ligjore të caktuar apo në trajtimin ligjor të një fenomeni specifik						
3.2.1	Mekanizma dhe instrumente të lidhura me informimin dhe ndërgjegjësimin publik, të përmirësuar			2024	2025		

Edukimi ligjor I qytetarëve të Lezhës në kuadër të reformës administrative-territoriale 2014

3.2.1 a	Informim i anëtarëve të Këshillit dhe publikut për çështjet vendimmarrëse (seminare ndërgjegjësuese për këshilltarët/ seminare mbi procesin vendimmarrës)	Bashkia	OSHC	6M II 2024	6M II 2025		
3.2.1 b	Nxjtja e qytetarëve për të qenë pjesëmarrës aktiv në proceset vendimmarrëse në Këshill. Lobimi dhe përfaqësimi i interesave të qytetarëve dhe kategorive në nevojë në çdo iniciativë ligjore (thirrje për komente/mendime dhe opinione)	Këshilli Bashkiak	Koordinatori për informimin publik	6M I 2024	në vazhdim	Kosto administrative	
3.2.1 c	Fushata ndërgjegjësuese dhe informuese për ligjin nr.111/2017; broshura dhe fletëpalosje specifike *Aktivitete që kryhen në vijimësi gjatë viteve të zbatimit të PV	ZJF	OSHC	6M I 2024	6M II 2025	100	
3.2.1 ç	Forume të hapura me pjesëmarrje të gjerë qytetare me qëllim marrjen e njohurive ligjore mbi ligjin nr.111/2017, sistemin e ndihmës juridike falas, kushtet/kriteret e përfitimit/subjektet përfitues/shërbimet që ofrohen etj. *Aktivitete që kryhen në vijimësi gjatë viteve të zbatimit të PV	ZJF	Strukturat komunitare në bashki	6M I 2024	2027	300	
3.2.1 d	Fushata ndërgjegjësuese me institucionet publike/ qeverisjen vendore/ dhe komunitetin për pasojat ligjore që kanë personat apo grupe personash që merren me kultivimin e bimëve narkotike, (programi: fushatë ndërgjegjësuese për luftën kundër kultivimit të bimëve narkotike - Kanabissativa)	Prefekti	Strukturat komunitare ne bashki Drejtoria e Policisë	6M I 2024	6M II 2026	Kosto administrative	
3.2.1 dh	Fushata ndërgjegjësuese me institucionet publike/ qeverisjen vendore/ dhe komunitetin për pasojat ligjore që kanë personat apo grupe personash që merren me kultivimin e bimëve narkotike, (programi: Zbatimi i Programit ndërgjegjësues në shkolla, “Jo alkoolit, duhani, marijuanës”)	Prefekti/ZVAP	Prefekti Drejtoria e Policisë	6M I 2024	6M II 2026	200	
3.2.1 e	Fushata ndërgjegjësuese, për të informuar shtetasit shqiptarë për rregullat dhe kushtet e udhëtimit pa vizë në BE, mundësitë e migracionit të rregullt dhe pasojat e migracionit të parregullt (si edhe aplikimeve të pabazuara për azil)	Drejtoria e Migracionit dhe Diasporës në Bashki	Prefekti Drejtoria e Policisë	6M II 2024	6M II 2026	150	
3.2.1 ë	Fushatë ndërgjegjësuese dhe informuese e komunitetit, të rinjve, nxënësve e mësuesve në shkolla (përfshirë Muajin Antitrafik) lidhur me: legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar, kuadrin institucional antitrafikim, format, metodat dhe fenomenin e trafikimit të personave dhe njohja me të drejtat e viktimës	ZVAP	Bashkia, Sektori i Policimit ne Komunitet	6M I 2024	6M II 2024	Kosto administrative	

Edukimi ligjor I qytetarëve të Lezhës në kuadër të reformës administrative-territoriale 2014

3.2.1 f	Fushata ndërgjegjëse: 12 Prill (dita e FSRR), 12 Qershor (dita kundër punës së fëmijëve) 20 nëntor (dita e të drejtave të fëmijëve) (I) Publikim i shtuar i ngjarjeve informuese me fokus të drejtat dhe mekanizmat institucionalë të mbrojtjes për fëmijët/të miturit (II)	Bashkia	Drejtoritë Rajonale OSHC	6M I 2024	6M II 2025	150	
3.2.1.k	Zhvillimi i trajnimeve me autoritetet publike dhe/ose kontrollues/përpunues në kuadër të zbatimit të ligjit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale	Koordinatori për mbrojtjen e të dhënave personale në bashki	OSHC	6M II 2024	6M II 2024	300	
3.3	Objektivi specifik 3.3: Rritja e kapaciteteve të individëve në ushtrimin e të drejtave të tyre, në aftësinë për të kuptuar dhe marrë vendimet e duhura						
3.3.2	Modelet e gatshme për vetëpërfaqësim në institucione të hartuara dhe publikuara	Bashkia Lezhë Këshilli Bashkiak	OSHC	2024	2025		
3.3.2 a	Hartimi dhe përditësimi i modeleve të vetëpërfaqësimit për qytetarët nga institucionet përkatëse, (përgjatë viteve 2024/2025/2026)	Bashkia Lezhë Këshilli Bashkiak	OSHC	6M II 2024	6M II 2025	Kosto administrative	
3.4	Objektivi specifik 3.4: Garantimi i informacionit ligjor në kohë reale dhe sa më pranë komunitetit						
3.4.1	Krijimi i kanaleve të komunikimit dhe informimit ligjor të qytetarëve për ELP-të			2024	2025		
3.4.1 a	Linjat telefonike “ <i>help line</i> ” që ofrojnë informacione rreth aspekteve të ligjit të krijuara në 12 NJQV (I) Hartimi dhe miratimi i rregullores tip për funksionimin e linjave telefonike “ <i>help line</i> ” (II) Përcaktimi dhe/ose përfshirja në strukturën e bashkive të punonjësve që do të ofrojnë shërbimet “ <i>help line</i> ” (III)	Bashkia Lezhë	OSHC	6M II 2024	6 M I 2025		
3.5	Objektivi specifik 3.5: Nxitja e aktivizimit të publikut përmes informimit mbi përgjegjësitë e institucioneve dhe mënyrat e pjesëmarrjes në vendimmarrje						
3.5.1	Ditët e Hapura pranë Bashkive/forume me qytetarë			2024	2025		
3.5.1 a	Hartimi i kalendarit të ditëve të hapura për çdo Bashki dhe Njësi Administrative (I) Përgatitja e materialeve të nevojshme për Ditën e Hapur (II) Zhvillimi i Ditëve të Hapura (disa ditë të hapura/vit) - (III)	Koordinatori i Informimit ZJF	OSHC Njësitë administrative	6M II 2024	6M II 2025	200	

Edukimi ligjor I qytetarëve të Lezhës në kuadër të reformës administrative-territoriale 2014

3.5.1 ç	Ditët e Hapura (disa ditë/vit) pranë Bashkive/forume me qytetarë për t'u njohur me punën e institucioneve dhe shërbimet që ofrohen në nivel lokal të zhvilluara (çështje të dhunës/mbrojtjes së fëmijëve)	91602AC (Aktivitet për bashkërendim procesesh mes bashkive)	OSHC	6M II 2024	6M II 2024	Kosto administrative	
3.5.1 dh	Qytetarë të informuar mbi bashkitë, mbi akte dhe dokumente informative dhe pjesëmarrje aktive në vendimmarrje (dokument miqësor "Plan dhe raport performance për aprovimin dhe monitorimin e parave lidhur me rezultatet"	Njesia e performancës në BASHKI	Këshilli Bashkiak	6M II 2024	Në vijim	Kosto administrative	
3.6	Objektivi specifik 3.6: Përmirësimi i programit të edukimit ligjor në lëndët bazë të arsimit parauniversitar dhe pasurimi i kurrikulave e aktiviteteve ekstrakurrikulare me elemente të edukimit ligjor						
3.6.3 b	Materiale informuese dhe ndërgjegjësime për çështje specifike (dhuna në familje/dhuna me bazë gjinore/eti), të përgatitura dhe të shpërndara në institucionet e arsimit parauniversitar, mësuesve dhe nxënësve	ZVAP ZJF	Bashkia Prefekti	6M II 2024	6M II 2025	200	
3.6.3 c	Fushata ndërgjegjësuese me lojën "Luaj dhe mëso – <i>Happy Onlife</i> " për nxënësit e shkollave 9-vjeçare *Aktivitet i organizuar 6M I/çdo vit	Shkollat 9-vjeçare	DRAP-ZVAP OSHC	6M I 2024	6M I 2025	200	